



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Beledijesi  
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 387/24 Dt. 25.06.2024



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për lejimin e punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, konform kërkesës së OE “MBG” shpk dhe kërkesës (raportit) të Menaxherit të Kontratës, për lejimin (aprovimin) e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: “Rregullimi i ndriçimit publik në fshatin Lukijë” projekt dy vjeçar, kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti, lejohen (aprovohen) punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 7.732.80 € (shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy euro e tetëdhjetë cent).
2. Pagesa e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t’i bëhet përfituesit të kontratës së punës nr. prok. 622-24-1959-521.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, nr. 54018.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Sektorit të Prokurimit,
  - Arkivës së Kryetarit.

